



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 167, datë 24.11.2022

**PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I STREHIMIT
SOCIAL
"SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social, nenin 47, 15, pikat 1,2, 3, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", "VKM 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore" VKM nr.453, date 3.07.2019." per masen e subvencionit te interesave te kredise dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", i ndryshuar me VKM nr.268, VKM nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" dhe V.K.B. nr.17 datë 10.02.2022 "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit, "Subvencionimi i interesave të kredisë", bazuar dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit dhe M.B.S, Këshilli Bashkiak Korçë,

VENDOSI:

1. Miratimin e 7(shtate) familjeve të cilat përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë", sipas listës bashkangjitur.
2. Familjet e përcaktuara në listën fituese, të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucioneve financiare si: Banka Raiffeisen, Banka Intesa Sanpaolo dhe Banka Kombetare Tregtare mbas njoftimit zyrtarë që kryen Bashkia Korçë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet e Drejtoria e Strehimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10-ditë pas shpalljes.

Kryetari Këshillit Bashkiak
Erjon NEXHIPI

